



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport

-XIII- Nr. i prot. 01 Br. prot. 01 Më 04.01.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC



RAPORTI VJETOR 2022

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

ABELA E PERMBAJTJES

rejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport _____

stërnjoftimi i shkurtër për Kulturën, Rinin, Sportin në Rahovec _____

ktivitetet e Muajit Janar _____

ktivitetet e Muajit Shkurt _____

ktivitetet e Muajit Mars _____

ktivitetet e Muajit Prill _____

ktivitetet e Muajit Maj _____

ktivitetet e Muajit Qershori _____

ktivitetet e Muajit Korrik _____

ktivitetet e Muajit Gusht _____

ktivitetet e Muajit Shtator _____

ktivitetet e Muajit Tetor _____

ktivitetet e Muajit Nentor _____

ktivitetet e muajit Dhjetor _____

blioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" _____

elestra Sportive "Mizahir Isma" _____

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Stërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rinin dhe Sportin në Rahovec.

Që komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës. Komuna ka shumë relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive, aktivitete muzikore, teatrale, bibliotekare, ekspozita, festivalë e aktivitete të ndryshme kulturore, si qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Drenoc gjetkë. Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi", me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe me mbi 33.000 çemplarë, si qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, e një dëshira të disa lagje të qytetit, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreacionit. Po ashtu, funksionojnë qendrat sportive, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rinore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rinore e sportive. Ndër aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen janë festivali i folklorit "Anadrinia Jehon" festa e Vjeljes së rrushit "Hardh Fest", "Agrofesta", Festivali ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rinore, sportive e promovuese.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbuluar e fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikore.

Në rapport të punës janë të përfshira aktivitetet të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekteve, në fushë kulturore, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.

Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktiviteteve të parapara të përfundojnë me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli i qendrave; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktivitetave të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive.

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xerxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.

- Stadiumin “Jahja Danuza” në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën “Mizahir Isma”.

Ërveq buxhetit të caktuar komunal, drejtoria ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes shkëputimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorët e dryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Farë kemi arritur?

Nënimet e mëposhtme përbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në dhjetor të vitit 2019, formata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së KRS-së.

Isa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë muajit janar:

Për nder të Ditëve Përkujtimore "Flaka e Janarit" është formuar këshilli organizues lidhur me zhvillimin e aktiviteteve kuadër të kësaj dite

- ❖ Në nderim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit, të rënë përgjatë Janarit të acartë të historisë sonë, në përpjekje parreshtura për mbrojtje të identitetit, për pavarësi dhe sovranitet të trojeve tona janë mbajtur homazhe në Celii Krushë të Madhe, Nagavc dhe Hoqë të vogël.
- ❖ Manifestimi përkujtimor është përmbyllur me ceremoninë përkujtimore në sallën e Kuvendit Komunal, ku vlen theksohet se u ndan edhe mirënjojje për të plagosurit më 27.01.1990.

Takim njoftues me shkollat, klubet dhe ojq-të sportive nga Komuna e Rahovecit për aktivitetet të ardhshme dëmbarvajtjen e tyre.



Shoqata e pedagogëve të kulturës fizike të Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, organizuan garat komunale në ping - pong me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë.



Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara muajit shkurt:

Për nder të 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës është formuar këshilli organizues lidhur me zhvillimin aktiviteteve në kuadër të kësaj dite.



- ❖ Në takim, këshilli organizues shqyrtoi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin sa më të mirë të kësaj ngja historike, ku u diskutuan idetë dhe aktivitetet që do të organizohen për nder të 17 Shkurtit Ditës e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- ❖ Janë mbajtur homazhe në nderim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit tek varrezat e dëshmorëve në Rahovec.
- ❖ Është organizuar aktivitete kulturore, përkujtimore e sportive "Turneu i Pavarësisë", në këtë organizim të Drejtorisë së Kulturës, Rini dhe Sport, janë mbajtur gara në disa disciplina të sportit: futboll në sallë, volejboll (për femra – kl. XII) e shah.
- ❖ Është bërë përrurimi i monografisë "Yjet e Lirisë", të autorit Sadik Krasniqi, nën patronazhin e kryetarit të komunës Rahovecit Smajl Latifi,
- ❖ Aktivitetet përkujtimore, kulturore e sportive në kuadër të shënimit të 14-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës u permbylliën me manifestimi qendror i cili u mbajt në qendrën e kulturës "Mensur Zyeraj".
- ❖ Manifestimet në shënim të 14-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës u pasuruan edhe me një ekspositë artistëve figurativ të Rahovecit, të organizuar në shoqatën "Art Studio". Në këtë ekspositë kolektive u shpalosën punimet e artistëve të Rahovecit, ku dominonte motivi atdhetar.



Takim me të rinjët e Komunës së Rahovecit në Qendrën Rinore "SHL-Kosova", në takim është diskutuar për qështje ndryshme, si aktivitetet e përbashkëta, trajnimet, debatet e aktivitetet të lira për të rinjët e Rahovecit. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sport ka si mision fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror e personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje te të rinjve në jetën aktive shoqërore si e ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë muajit mars:

Në fshatin Dejnë kane filluar punimet në infrasukturën e amfiteatrit të festivalit “Anadrinia Jehon”.

- ❖ Në hapësirat e tij, amfiteatri është i pajisur edhe me skenën, podiumin, dhomat e zhveshjes së artistëve, gjithashtu edhe me ndriçim publik.
- ❖ Një amfiteatër natyror është një hapësirë e performancës, e vendosur në një vend ku një ambient i pjerrtë bënë jeho duke e bërë atë ideal për shfaqje muzikore dhe teatrale.
- ❖ Amfiteatri i festivalit “Anadrinia Jehon”, do të shërbejë për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë së mbarëkombëtare, duke përzgjedhur në të krijimet më autentike e më të lashta që populli shqiptare ka krijuar ndër sheshet.
- ❖ Ky objekt kulturor do të synojë gjallërimin e jetës kulturore të vendit në përgjithësi si dhe të komunës së Rahovecit, që rajon është i pasur me trashëgimi kulturore, duke përcjellë tek spektatorët dhe vizitorët vendas dhe të huaj, kulturi popullore që ruhet dhe kultivohet në hapësirat mbarëkombëtare.

Është publikuar thirrja për mbështetjen financiare publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, shoqata për organizimin e aktiviteteve Kulturore e rinore.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bëri thirrje të gjitha, OJQ-ve, Shoqatave të regjistruara Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushën e kulturës dhe rinisë, të aplikojnë mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e kulturës dhe organizimin ronor gjithë duke u bazuar në politikat programore të DKRS-së, në Komunën e Rahovecit.

Në kuadër të ditëve të Epokes së UÇK-së” për tri ditë me radhë me datë 5,6,7 Mars i kujtojtuam dhe nderuam të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët, të cilët nuk kursyen jetën për të realizuar një ëndërr që është bartur tek ne brez brezi – Lirinë!



Në Biblioteken Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec u përvurua Këndi Arkivor i Drejtorisë së Përgjithshme Arkivave të Shqipërisë.

- ❖ Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.
- ❖ Ky kënd do t'i mundësojë studiuesve dhe hulumtuesve shkencor që të kenë qasje në dokumentet arkivore r Rahoveci, pa pasur nevojë të shkojnë në Tiranë apo Prishtinë.
- ❖ Këndi Arkivor u hap me kontributin e DKRS-së në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" dhe aty do të ke qasje të gjithë ata që dëshirojnë të marrin dokumente dhe të dhëna arkivore, qoftë në Tiranë apo në Prishtinë.



Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi orë letrare me kriji dhe nxënës të shkollave të mesme e filllore të Rahovecit.

- ❖ Me këtë rast drejtori i DKRS-së Afrim Dina falënderoi poetët për bashkëpunimin dhe i siguroi se kjo drejtori ec në të ardhmen do të vazhdojë të mbështesë në forma të ndryshme krijimtarinë letrare.
- ❖ Zyrtari i DKRS-së Qemajl Krasniqi foli për rolin e poezisë në tërësinë e krijimeve letrare, ndërsa lidhur ndërlidhjen e krijimtarisë gojore dhe poezisë, një vështrim kronologjik e bëri Prof. Dr. Sabahajdin Cena.
- ❖ E krijuesit Blerta Nalli-Gashi, Hazir Luta, Milazim Bajraj, Hysen Berisha, Valbona Hoti dhe disa krijues të r paraqitën disa krijime artistike të tyre dhe të autorëve të ndryshëm.
- ❖ Në këtë ceremoni disa nga krijuesit i dhuruan përbledhje me poezi e romane Bibliotekës Komunale "Sulej Krasniqi", dhurata që i pranoi drejtori Afrim Dina.



Isa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë muajit prill:

Me rastin e Ditës Botërore të Librit dhe të drejtës autoriale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Rahovec organizoi aktivitete

- ❖ Takime me krijues dhe promovim të veprave letrare.
- ❖ Më 22 prill 2022 në orën 11:00 eshte organizuar një bashkëbisedim me shkrimitarit dhe hulumtuesit shkencor Fari Xharra.
- ❖ Aktivitetet janë mbajtur në lokalet e qendrës rimore SHL Kosova dhe janë organizuar në bashkëpunim i Klubin e Karrierës të shkollës së mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec.
- ❖ Në Qendrën e Kulturës "Mensur Zyberaj" është bërë promovimi i monografisë "Për të gjallë kullat nuk i lëshojmë", kushtuar dëshmorit të kombit SADEDIN HASANI, shkruar nga Gëzim Ajgeraj.

❖

Për ndër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës e cila shënohet në të gjithë botën përmes aktiviteteve të shumta që synon të rrisin ndërgjegjësimin qytetar ndaj çështjeve mjedisore.

- ❖ Përmes punëve vullnetare, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me drejtorit Arsir Drejtirinë e Shërbimeve Publike dhe të Urbanizmit zhvilluan aktivitete të shumta në pastrimin, rregullimin dhe mbjelljen luleve dhe fidaneve në hapsirat e qytetit te Rahovecit.

Më 23 prill 2022 në shënim të Ditës Botërore të Librit dhe të Drejtës Autoriale, në mjediset e Qendrës Kulturore "Men Zyberaj" në Rahovec u bë promovimi i monografisë "Për të gjallë kullat nuk i lëshojmë", kushtuar dëshmorit të komunitetit Sadedin Hasani.



Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë muajit maj:

Takimi i këshillit organizues të festivalit Anadrinia Jehon 2022, gjatë këtij takimi këshilli organizues shqyrtoi çështje ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin e edicionit të 21-të, të festivalit Anadrinia Jehon që mbahet në fshatin Dejku u diskutuan të arriturat e deri tanishme të organizimit, konfirmimi i grupeve pjesëmarrëse, u ndanë përgjegjësitë dhimorë vendimi për anëtarët e jurisë profesionale.

28 organizata joqeveritare, rimore, sportive dhe kulturore, që veprojnë në komunën e Rahovecit, përfituhën subvencionim direkt nga Komuna e Rahovecit.

- ❖ Drejtoria e Kulturës, Rinis dhe Sportit ju dha përkrahjen e merituar për t'i mbështetur projektet e tyre, që burojnë shkathtësitë e tyre në fusha të ndryshme. Vlera e përkrahjes për këto OJQ përfituese nga Komuna e Rahovec për këtë vit është 121,500.00 €.



Përurimi i fushës sportive tek Shkolla e Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec!

- ❖ Kjo fushë do ju shërbej nxënësve të kësaj shkolle të cilët tanimë kanë një fushë sportive moderne ku mungojnë aktivitetet e tyre.



Me sukses është përmbyllur edhe një edicion i festivalit të folklorit Anadrinia Jehon

- ❖ Ecuria e mirë e edicionit të njëzenjetë të festivalit Anadrinia Jehon dëshmoi për punën dhe përkushtimin e Kësh Organizues, banorëve të fshatit Dejnë, strukturave të pushtetit lokal dhe pjesëmarrësve në këtë festival.
- ❖ Ky edicion tregoi se ky aktivitet kulturor, me karakter kombëtar, është konsoliduar tashmë dhe ka vënë themel fortë.
- ❖ Pjesëmarrja e njëzet e dy grupeve artistike nga vise të ndryshme shqiptare dhe nga mërgata, është dëshmi e kës E veçanta e këtij edicioni ishte prania e grupit artistik arbëresh "Gjaku i Arbërit" nga Kalabria.
- ❖ Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi priti me kënaqësi në zyrë këtë grup të drejtuar nga Mikele Greko, shoqëruar r nënkyetarja arbëreshe e komunës San Martino di Finita, zonjën Ilari Likursi, me të cilët shkëmbjen dhuri simbolike. Ishte shumë emocionues fakti se këta entuziastë të kulturës populllore, të cilët edhe pas gjashtëq vjetësh ende komunikonin në shpen arkaikë. Programi i tyre në skenën madhështore të festivalit Anadrinia Jehon priti me entuziazëm dhe me duartroktje të vazhdueshme të publikut të shumtë në numër. Prandaj edhe çmi "Mirënjojje e veçantë" për këtë grup ishte më se i merituar.




Në shënim të Ditës Botërore të Muzeve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, respektivisht sektori për Rininë, organi një vizitë në Qendrën e Dokumentimit të Fondit për të Drejtën Humanitare, e hapur në mjediset e bibliotekës "H Sulejmani" në Prishtinë.

- ❖ Nxënësit e shkollave të mesme "Xhelal Hajda-Toni" dhe "Selajdin Mullabazi-Mici", patën rastin të informohen nga Bel Blakaj, drejtor ekzekutiv i Fondit për të Drejtën Humanitare-Kosovë, rreth punës dhe misionit të kësaj organizate i dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec 28 maj 2022

- ❖ Me aktivitete të shumta është shënuar Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec, në aktivit pjesëmarrës ishin kryetari i komunës z. Smajl Latifi, zyrtarë komunalë, familjarë dhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve
- ❖ Aktivitetet kanë filluar me homazhe dhe nderime te pllaka përkujtimore e heronje dhe dëshmorëve të kombit është bërë prezantimi i aktiviteteve dhe sukseset e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport nga janari e deri më tanë.
- ❖ Aktivitetet në qendrën kulturore "Mensur Zyberaj" janë mbyllur me një program artsistik të përgaditur nga Shoqë Kulturore Artistike "Bajram Curri" nga Krusha e Madhe.



Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë muajit qershor:

Me rastin e Ditës Botërore të Fëmijëve -1 Qershorin, në bashkëpunim me DKA dhe shoqatën "Hareja" në Rahovec është organizuar program festiv për fëmijë.


- ❖ Aktivitetet fëmijët i filluan me vizitën e tyre tek kryetari i komunës së Rahovcit z. Smajl Latifi, pastaj vazhduan defilim nga shoqata "Hareja" deri tek shtëpia e Kulturës "Mensur Zyberaj" ku edhe shfaqën një program të pasur këngë, valle, skeqe dhe poezi të përgaditur nga mësueset e Harejës dhe mësueset e katër shkollave fillore të qytet



Në kuadër të manifestimit për Ditën e Çlirimit të Rahovcit, më 14 qershor, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

- ❖ Homazhe tek varrezat e dëshmorëve në Rahovec;

- ❖ Me nxënësit e klasave të dhjeta të SHML "Xhelal Hajda - Toni" është mbajtur një ekspozitë me punimet e tyre të buk në picture, e veçanta e këtyre punimeve ishte se të gjitha ishin piktura të punuara në pëlhirë. Kjo ekspozitë u vizi edhe nga kryetari i komunës, drejtorë të drejtive komunale dhe nga shumë qytetarë, të cilët u kënaqën duke p këto punime të bucura artistike të nxënësve;
- ❖ Aktivitetet kanë vazhduar me koncertin festiv me këngëtarët e estradës të Komunës së Rahovecit.
- ❖ Ne ditëlindjen e 79 të veprimitarit dhe intelektualit të shqar shqiptar nga Krusha e Madhe, Ukshin Hoti, me 17 qershor 2022, në shtëpinë e tij muze i eshte dhene dekorata "Ukshin Hoti" z. Dervish Qadraku.
- ❖ Gjithashtu ne kete dite eshte bere edhe promovimi i projektit më të ri i këngëtarit Ilir Shaqiri, që i kushtohet Ukshi Hotit "Tempulli i lirise".



AKTIVITETET E MUAJIT KORRIK

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- **Për ndër të “Epopes së Korrikut 1998”**, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përcjellur dhe organizuar aktivitete përkujtimore, në bashkëpunim me organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-dega në Rahovec.
 - Homazhe te Muri i Pikëllimit dhe vendrëniet e dëshmorëve: Abdullah Bugari dhe Gëzim Hamza-Piktori-Rahovec.
 - Homazhe te vendi i betejës – Përmendorja e dëshmorëve në Fortesë.
 - Homazhe te lapidari i dëshmorëve në rrugën “UÇK” (transiti Rahovec-Malishev).
- Homazhe te shtatorja e Shejh Myhedin Shehut- te Teqeja e Madhe e Halvetive –Rahovec.
 - Homazhe te lapidari – Popma Teuta-Rahovec.
 - Homazhe për dëshmoret te kompleksi përkujtimor “Maja e Shkodranit” Rahovec.
 - Më 15 korrik 2022 kanë filluar aktivitetet për muajin e mërgimtarëve sipas agjende




**SOFRA
MËRGIMTARIT**

ME BASHKATDHETARË NË FSHATIN DRENOC


DATA: 28 KORRIK 2022 VENDE: NË QENDRË TË FSHATIT ORA: 20.00h

Cħab so nist!

DIREKTORI
S. DIET E MËRGIMTARIT
FONDU TA' L-IMPREM



Aktiviteti "Sofra e Mërgimtarit në Drenoc"




Aktivitete Sportive në Ditën e Epopesë së Korrikut

- ❖ Manifestimet kulturore e përkujtimore në shënim e Epopesë së Korrik.

AKTIVITETET E MUAJIT GUSHT

jatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe atë angazhime të ndryshme:

- Organizimi i aktiviteteve për muajin e mërgimtarëve sipas agjendës, është mbajtur koncert me datë 26.7.2022 në Qytet dhe me datë 28.7.2022 është mbajtur aktiviteti "Sofra e Mërgimtarit" në Drenoc
 - Është bërë riparimi fushës së tenisit te shkolla e mesme "Xhelal Hajda"
 - Vazhdimi i tereneve sportive në fshatrat Reti e eperme, Celinë dhe Gexhë
 - Promovimi i monografis "Deri në frymën e fundit" për dëshmorin Skender Gashi, të autorit Qemajl Krasniqi.
 - Më 02.08.2022, është mbajtur aktiviteti "Sofra e mërgimtarit" në Krushë të Madhe
 - Fillimi i punimeve për rregullimin e parkut ne fshatin Nagvc.
 - Inspektimin e punëve në kuadër të DKRS-së.
- Më datë 9.08.2022 në Ratkoc është mbajtur koncert "04 BAND",
 - Më 15.08.2022 është mbajtur Koncerti përbyllës i Muajit të Mërgimtarëve



AKTIVITETET E MUAJIT SHTATOR

Gjatë muajit shtator ne si Drejtori e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kemi kryer këto aktivitete:

- Më 03 shtator në kaudër të "Hardh Festit", është organizuar Hardh Mini Maratona në bashkëpunim me SH-L Kosova.
- Me datë 25.9.2022 në Qendren e Kulturës "Mensur Zyberaj" është mbajtur Festivali mbarëkombëtar i këngës për fëmijë "Kokrrat e rrushit këndojnë" ku kanë marrë pjesë 18 solist nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.
- Më 15 shtator 2022 është bërë përrurimi i fushës së sportit në fshatin Reti e Poshtme

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë këtij muaj



AKTIVITETET E MUAJIT TETOR

jatë muajit tetor Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete për festat e amurtit 28 nëntor, patë angazhime të ndryshme si:

1.Turne në volejboll

2.Koncert festiv

ë aktivitetin sportiv në Volejboll morrën pjesë 10ekipe, ku vendi I pare dhe I dytë u hpërblyen me kupa dhe medalje nga DKRS-ja.

Ie një program të pasur festiv të mbajtur në Palestrën sportive "Mizahir Isma" me 28 nëntor performuna shoqeria Kulturoartistike "Bajram Curri", ansamblı I këngëve dhe valleve "Emin Duraku" nga Shkupi si dhe ansamblı I këngëve dhe valleve "Ibe Palikuqi" nga Shkupi programin festive e pasuruan edhe grupi I këngëtarëve "04 BAND".



Programi festiv për ditën e flamurit 28.11.2022-Rahovec.

AKTIVITETET E MUAJIT DHJETOR

Në kuadër të shënimit të Ditës së Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", Zyra e Kryetarit të Komunës dhe DKRS organizuan një manifestim kulturor, në kuadër të të cilit u mbajt edhe tryeza me temë: Roli dhe ndikimi i Sulejman Krasnicë Lëvizjen ilegale shqiptare. Me kumtesa u paraqitën; veprimtari Mehmet Hajrizi, Prof. dr. Ermelinda Kashahu studiuuese gjatë Gjirokastra, prof.dr. Sabahajdin Cena, Prof.dr. Kudusi Lama, Dr. Shyqri Galica kryetari LSSHK, Fitore Rexhep Mala e libana Sulejman Krasniqi.

Juria profesinale e konkursit letrar "Sulejman Krasniqi", publikoi edhe vlerësimet profesionale të krijimeve letrare - tistike. Juria në përbërje: Prof.dr. Besim Muhadri, Leonita Parallangaj, magjistre e letërsisë dhe Sokol Gashi, profesor i juhës dhe i Letërsisë, shpallën tre fituesit e këtij konkursi.

Vendi i tretë iu nda poezisë "Dilemë" me shifrën "Dora D'Istria".

Në vendin e dytë u rendit tregimi me titull "Berberi" me shifrën "Artemisa 2022".

Ndërsa vendi i parë iu nda poezisë me titull "Për tokën time" me shifrën "Dallëndyshja me fole Kosove".

Më pas mysafirët vizituan edhe bibliotekën komunale që mban emrin e shkrimtarit Sulejman Krasniqi.



' Dhjetor dita e Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec.

ë fund të këtij viti, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, organizoi ceremoninë e zgjedhjes së laureatëve të sportit për viti 2022 në komunën tonë.

Sportistët që spikatën me rezultate të larmueshme gjatë këtij viti, ishin:

Sportistja me prespektivë – Elma Sharku;

Sportisti me prespektivë – Sinan Kadiri;

Ubi i vitit 2022 – KH “Rahoveci”;

Ajneri i vitit 2022 – Xhafer Bytyqi;

Jyqtari i vitit 2022 – Taulant Haxhimustafa;

Unëtori sportiv i vitit – Burim Dula

Eteran aktiv i sportit, gjatë vitit 2022 – Bekim Cena;

Eteran sportiv i vitit 2022 – Sadedin Cena;

Ne,

Sportisti i vitit 2022 u zgjodh – Kenan Haxhihamza

Erkrahja jonë për sportin dhe për të gjitha disiplinat sportive do të jetë e vazhdueshme.

Rime dhe suksese edhe më të mëdha në vitin 2023, të dashur sportistë dhe sportdashës!



0.12.2022. Aktivitetit i perzgjedhjes së Sportistit të vitit-Rahovec.

BIBLIOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI”-RAHOVEC

- Përgaditja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

jatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirë të librit: mësimdhënies, nxënës, shkrimitarë të komunës sonë, ënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexueshmërisë.

blioteka në tërsi ka ruajtur vazhdimësinë e punës së saj profesionale në shërbim të lexuesve, të atyre përdoruesve që kësaj asur nevoja për shërbime të ndryshme, si në kërkim të librit, në shfrytëzim të sallës dhe shërbimeve të tjera.

Ktivitetet për muaj Janar-Qershori

- Nxënësit e klasës së X dhe XII-të të SHMPL – “Selajdin Mullabazi- Mici” të shoqëruara nga mësimdhënëset Znj. Shkënd Popaj dhe Znj. Anita Gashi – Kadiri në mënyrë të organizuar vizituan bibliotekën “Sulejman Krasniqi” – Rahovec. Njoftuan për së afërm me fondin e librave për fëmijë dhe të rritur, me hapësirat e rehatëshme për lexim si dhe rrëgjistrimit dhe huazimit të librit.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës nga autorri Mazlum Baraliu me 8 ekzamplar të librit me titull: “Tribunë dhe Korife” si dhe me 3 ekzamplar nga autorri Shemsi Krasniqi me titull: “Arti Shkëmbor i Kosovës”.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës nga autorri Sali Bytyqi me 5 ekzamplar të librit me titull: “Analogji poetike” si dhjetë ekzamplar nga autorri Bajram Bektishi me titull: “Bulbëri mendimesh”.
- Biblioteka “Ibrahim Rugova”- Gjakovë ia dhuroi bibliotekës sonë 1 ekzemplar të autorës Samile Rasim Doli, me titull: “Historiku i Shkollës së Mesme Ekonomike Kadri Kusari-Dushi në Gjakovë”- prej vitit shkollor 1990/91 deri në vitin 1998/99.
- Me datë: 08.03.2022 - Në Bibliotekën Komunale “Sulejman Krasniqi”- në Rahovec u përrurua Këndi Arkivor i Drejtoria së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë. Në këtë përrurim morën pjesë: Kryetari i Komunës së Rahovecit Smajl Lala, Drejtori i Drejtorisë së Arkivave të Shqipërisë Dr. Ardit Bido, Kryeshefi Ekzekutiv të ASHAK-së Mr. Bedri Zyberaj si i cili është Drejtor i Drejtorisë së Arkivave të Shqipërisë, Dr. Afrim Dina së bashku me stafin e DKRS-së. Hapja e këtij Këndit Arkivor do t’iu mundësojë studiuesve të vizituar hulumtuesve shkencore që të kenë qasje në dokumentet arkivore nga Rahoveci.
- Me datë: 21.03.2022 – Në shënim të Ditës Botërore të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi një letrare me krijues dhe nxënës të shkollave të mesme e filllore të Rahovecit. Në këtë orë letrare morën pjesë: Prof. Sabahajdin Cena, Blerta Nalli – Gashi, Hazir Luta, Milazim Bajraj, Hysen Berisha, Valbona Hoti dhe disa krijues të tij.

paraqitën disa krijime artistike të tyre dhe të autorëve të ndryshëm. Për nder të Ditës Botërore të Poezisë disa auto dhuruan Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi" përbledhje me poezi e romane si: Hysen Berisha "Arba ekzemplar po ashtu përbledhje poezish me titull "Jetë valixhesh" 5 ekzemplar, Grup autorësh "Djepi i Liri (Antologji) 5 ekzemplar, Shani Hoti "Ditar nga burgu" 2 ekzemplar si dhe Valbona Hoti "Unë prapë jetoj" 9 ekzemplar.

- Me datë: 28.03.2022 – Në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" u mbajt solo koncerti i kitaristit Elbasan Krye me të cilën promovuan disa muzikantë.

❖ **Perurimi i fondit librar: 47 ekzemplar.**

Dhuratë nga Kryetari i Komunës me 2 tituj 11 ekzemplarë.

Dhuratë nga Autori Sali Bytyqi me 1 tituj 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Bajram Bekteshi me 1 tituj 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Biblioteka Ibrahim Rugova me 1 tituj 1 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Valbona Hoti me 1 tituj 9 ekzemplar.

Dhuratë nga Grup autorësh me 1 tituj 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Hysen Berisha me 2 tituj 9 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Shani Hoti me 1 tituj 2 ekzemplar.

❖ **Sektori i huazimit të librit:**

anë regjistruar: Anëtar 235, Sh.Fillore 182, Sh.Mesme 27, Student 13, Të tjerë 13.

Djem 88, Vajza 147.

Me pagesë 229, Falas 6.

Shërbime me libra: 789, Djem 311, Vajza 478.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar: 67 përdorues.

❖ **Fondi total**

Fondi total i bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec është: **19.940 libra.**

Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec – Dega në Krushë e Madhe dhe Ratkoc

Raport i punës përmes muajin Janar-Dhjetor 2022

Sektori i huazimit të librit:

Janë regjistruar: Anëtar 949, Sh.Fillore 782, Sh.Mesme 79, Student 43, Të tjerë 45.

Djem 362, Vajza 587.

Me pagesë 928, Falas 21.

Shërbime me libra: 3963, Djem 1499, Vajza 2464.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 934 përdorues.

Pasurimi i fondit librar: 824 ekzemplar.

undi total i librave në bibliotekë: 26065 ekzemplar.

Anëtarësia dhe libra të lexuara në bibliotekë për muajin Janar-Dhjetor 2022

Muaji	Anëtar	Me pagesë	Falas	Libra të lexuara	Djem	Vajza
Janar-Nëntor	949	928	21	3963	1499	2464

Tabela e lexuesve për muajin Janar-Dhjetor

Muaji	Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student	Të tjerë	Djem	Vajza	Gjithsej
Janar-Nëntor	782	79	43	45	362	587	949

PALESTRA SPORTIVE “MIZAHIR ISMA”

jatë kësaj periudhe Janar-Dhjetor në palestrën sportive “Mizahir Isma” janë realizuar aktivitetet të shumta sportive, si
ublet të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtar, ndër aktivitetet tjera janë:

aktivitetet për muajin Janar-Dhjetor

Klubi Basketbollistik “KB – Rahoveci”, garon në dy kompeticione garuese në Superligën e Basketbollit dhe Ligën U
mbëtare. Në Superligën e Kosovës si ekip nikoqir ka zhvilluar 7 (shtatë) ndeshje, ndërsa në Ligën Unike ka zhvilluar 4 (ka
deshje zyrtare).

Klubi basketballistik “KB-Rahoveci”, si vendas në palestër ka zhvilluar gjithësej 31 ndeshje të kampionatit

Hendballistik “KH-Rahoveci”, garon në Superliga e Hendballit të Kosoës në muajt janar, shkurt, dhjetor ka zhvilluar 1
ndeshje ndeshje zyrtare në Palestër.

ubi i Futsallit “FC-Rahoveci 2019”, garon në ligën e Parë e Kosoves në Futsall dhe ambiciet kryesore të ekipës inkuadri
tin e ardhshëm.

Gjatë muajve janar, dhjetor si nikoqir ka zhvilluar 10 dhjetë, ndeshje.

ubi i futsallit “KFS-Rahoveci”, garon në Ligën e Parë të Kosovës në Futsal, dhe qellimi i klubit është të aktivizojë sa më shu
ni në sportin e futsallit.

ubi i Futsallit “KF-Burimi”, garon në Ligen e Parë të Kosovës në Futsall dhe për qellim ka aktivizimin e rinis në sportin e
itsallit ku dhe është viti i parë që merë pjesë në keto gara.

Gjatë muajve janar, dhjetor, ka zhvilluar 10 (dhjetë) ndeshje në gara kampionale.

nvillimin e garave në Pin-Pong nga shoqata e pedagogeve të kulturës fizike pjesëmarres kanë qen shkollat fillore nga kom
Rahovecit.

Turnir për nder ditës së Pavarësis 17 shkurt ku kanë qenë pjesëmarrës të gjitha ekipet nga komuna e Rahovecit. Turështë zhvilluar në futboll të vogel, shah dhe volejboll.

14 Qershor për nderë të ditës së Qlirimit Komunës së Rahovecit turnir në futbollë të vogel.

Java e Mergimtarëve turnir në futbollë të vogel

28 Nëntori turnir në vlojlebollë

TOTALI I AKTIVITETEVE NË PALESTRËN SPORTIVE JANË 72 AKTIVITETE

Aktivitete ne Kultur dhe Rini

- **Janar, 2022**
- 27, janar – Aktivitete kulturore, homazhe “Flaka e Janarit”.
- **Shkurt, 2022**
- Aktivitet, përvimi i monografisë “Yjet e lirisë” autor Sadik Krasniqi.
- Aktivitete kulturore (akademi, eksposít, koncert), turir dhe homazhe, “17 Shkurti “Dita e Pavarsisë”.
- **Mars, 2022**
- 05,6,7 mars, aktivitete dhe homazhe në shënimin e epopesë së UCK-së.
- 25, mars – 02 prill, aktivitete dhe homazhe përkujtimore, në nderim të të rëneve të komunës sonë, aktivitetet realizohen në bashkëpunim me OVL-UCK-në.
- 21, mars – aktivitet shënim i Ditës ndërkontaktare të Poezisë.
- Mars, 2022, përvimi i këndit Arkivor të Tiranës në ambientet e bibliotekës komunale “Sulejman Krasniqi”, Rahovec.
- **Prill, 2022**
- Aktivitete dhe homazhe në nderim të Dëshmorëve të komunës sonë 12-26 prill.
- 22, prill - aktivitete, shënim i ditës ndërkontaktare të Librit.
- 22, prill – aktivitete në shënimin e ditës ndërkontaktare të Tokës.
- 23, prill - në qendrën ekulturës “Mensur Zyberaj”, është bërë promovimi i monografisë për Dëshmorin Sadedin Hasani.
- **Maj, 2022**
- Që nga data 05-12 maj, kemi realizuar aktivitete kulturore, sportive dhe përkujtimore, në bashkëpunim me OVL-UCK, me rastin e shënimit të “Javës së Dëshmorëve”, të komunës së Rahovecit.
- 11,12,13, maj – organizimi dhe mbajtja e festivalit folklorik “Anadrinia Jehon-2022”.
- **Qershor, 2022**
- 16, maj - aktivitet në shtëpinë muze “Ukshin Hoti”, shënim i ditës së szhdukjës së veprimtarit Ukshin Hoti.
- 18, maj – aktivitetet kulturor, shënim i ditës botrore të Muzeve.
- 26-28, maj – aktivitet dhe homazhe organizuar nga DKRS dhe OVL-UCK, në nderim të dëshmorëve.
- 28, maj - aktivitete kulturor shënim i ditës së qendrës kulturore “Mensur Zyberaj”, Rahovec.
- **Qërrshor, 2022**
- 01, qërrshor, shenimi i ditës ndërkontaktare të Fëmijëve, aktivitet organizuar në bashkëpunim me OJQ “Hareja”.
- 03, qërrshor – aktivitet kulturor-përkujtimor, zbulimi i bustit të heroit të Kosovës Skender Regjipi, fshati Mrasor.
- 04, qërrshor – në ambientet e shtëpisë së kulturës “Jahë Hoti” në fsahtin ratkoc, është bërë promovimi i monografisë “Yjet e Lirisë” të autorit sadik Krasniqi.
- 14, qërrshor – për nderë 14 qershorit - ditës së cilimit të komunës së Rahovecit, kemi realizuar aktivitete të shumtë kulturore dhe sportive.
- 17, qershor – aktivitet në shtëpinë muze “Ukshin Hoti”, me rastin e datëlindjës së veprimtarit Ukshin Hoti.
- **Korrik, 2022**

- 17, korrik – aktivitete dhe homazhe në shënimin e Epopesë së Korrikut.
- 15, korrik – fillimi i aktivitetave në fshatin Drenoc, muaji e mërgatës “ Sofra e mërgimtarit”.
- 27, korrik – koncert festiv në Rahovec, muaji I mërgatës.
- Promovimi i librit kushtuar dëshmorit Skender Gashi.
- **02, gusht** – aktivitet Sofra e Mërgimtarit, Krushë e Madhe.
- 15, gusht – koncert përmbyllës në Rahovec për muajin e mërgimtarëve.
- **Shtator, 2022**
- Aktivitete kulturore për “Hardh Fest”, minimaraton me vizitore nga vendi dhe jasht, monumenteve kulturo-historik
- 25, shtator – në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj”, është mbajtur festival ndërkombëtar për fëmij “Kokrrat e rrujë këndojn”.
- 06, nëntor – aktivitete dhe homazhe ditët “Toni e Mici”
- 10, nëntor – në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj”, është mbajtur koncerti “N’Rahovec e kem konakun”.
- Aktivitete për ndër të 28 nëntorit, ditës së Falmurit Kombëtar: promovimi i librit Kronik nëpër Stuhin të autorit përshtatur Sabahudin Cena, eksposít dhe koncert festiv.
- **Gjithsej aktivitete: 33**

Ne te gjitha aktivitete e mbajtura nga DKRS-ja ne vitin 2022 pjesemarrija e qytetareve ka qen e kenaqshme, e sidon vlen te theksohet ne aktivitete e organizuara gjate muajit te mërgimtarëve 15 korrik 15 gusht.

rejtoria per Kulture, Rini dhe Sport kete vit ka hartuar Planin 3 vjeçar per Trashegimi Kulturore e Historike ne komune e Rahovecit.

INVESTIMET KAPITALE

e Drejtorin per Kulture, Rini dhe Sport gjate vitit 2022 janë bere dhe po behen investime te shumta ne infrastrukturë si terrene sportive, parqe dhe monumente te trashegimis Kulturore.

Vestimet ne terenet sportive gjate ketij viti janë peruruar kater terene sportive si ne: Rahovec tek shkolla profesionale ”Selajdin Mullabazi”, Zoqisht, Reti e Poshtme dhe Celine. Kurse ne fshatin Gexhe eshte ne perfundim e siper, punimet janë zhduar ne Kompleksin Sportiv te Epopeja e UCK-se

Janë bere perurimi I Amfiteatrit ne fshatin Dejn, perurimi I kreditit recreative te Maja e Shkodranit, punimet janë dëzhduar tek shtepia muze “Ukshin Hoti”, muzeu tek kompleksi I deshmoreve si dhe aneksi te shtepia e kultures ne Krushë adhe, rregullimi I bibliotekes ne Xerrxe.

Junimet ne rregullimin e parkut te stacioni I autobusave janë ne perfundim, kemi filluar me rregullimin e parkut ne fshat agavc.

E gjitha projektet ne investimet kapitale si ne terenet sportive, parqeve e monumenteve kulturore do te vazhdohen ne vitin 2023 ne teritorin e komunes sone.

YËRFUNDIMI

rejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç aktivitetave të parapara për periudhën kohore janar-dhjetor 2022 ës igazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve sportive;
- Takime me klube dhe shoqata sportive;
- Vizitë objekteve kulturore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- Organizimi i aktivitetave kulturore, rinore dhe sportive;
- Monitorimi i aktivitetave të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së;
- Përgaditje të raporteve javore, mujore, tremujore, gjashtëmuajore dhe vjetore.

Orahovac,

dhjetor, 2022



Drejtor i DKRS-së

Afrim Dina